



AGJENCIA KOMBËTARE  
E ARSIMIT, FORMIMIT  
PROFESIONAL DHE  
KUALIFIKIMEVE

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT  
FORMIMIT PROFESIONAL DHE  
KUALIFIKIMEVE

## **RAPORT VJETOR**

1 janar-31 dhjetor 2014

TIRANË, JANAR 2015



## Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje.....	2
Zhvillimi institucional dhe gjendja e AKAFPK-së.....	3
Ecuria.....	3
Sfidat.....	4
Aktivitete të tjera të institucionit janar-dhjetor 2014 .....	5
Shërbime të realizuara sipas planit vjetor të punës .....	7
ANEKS .....	10
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale. Raport, Janar - Dhjetor 2014 .....	10
Sektori i Sekeltkurrikulave dhe Standardeve të Trajnimit të Mësuesve. Raport, Janar - Dhjetor 2014.....	22
Sektori i Vlerësim-Certifikimit të Nxënësve& Akreditimit të Ofruesve të AFP-së. Raport, Janar-Dhjetor 2014 .....	31
Sektori i Administratës, Financës dhe Teknologjisë së Informacionit. Raport, Janar - Dhjetor 2014 .....	45



## Përmbledhje

Qëllimi i këtij raporti është të informojë Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS) mbi ecurinë e aktiviteteve të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) në periudhën 1 janar- 31 dhjetor 2014.

Në këtë periudhë të varësisë së dyfishtë ndërmjet Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, AKAFPK ka rakorduar planin e saj vjetor të punës në përputhje me prioritetet e fushës së përgjegjësisë së MMSR-së për arsimin dhe formimin profesional, ndërsa ka vepruar në përputhje edhe me politikat e arsimit parauniversitar në tërësi, nën varësinë e MAS.

Për vitin buxhetor 2014, AKAFPK është një institucion nën varësin e MAS dhe i raporton kësaj të fundit në bazë tre dhe gjashtë mujore.

Raporti në vijim - i ndërtuar në kapituj – prezanton punën e institucionit për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2014 duke u fokusuar në:

1. Zhvillimin dhe gjendjen dhe sfidat e institucionit
2. Aktivitetet e zhvilluara gjatë periudhës 1 janar-31 dhjetor 2014
3. Raportin e produkteve (shërbimeve) të ofruara sipas planit të punës së sektorëve
4. Aneks: Realizimet e detajuara për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2014



## Zhvillimi institucional dhe gjendja e AKAFPK-së

### Ecuria

Viti 2014 ka qenë një vit tranzicioni për AKAFPK, e cila është përfshirë në të gjithë procesin e reformimit të sistemit të arsimit dhe formimit profesional me ndryshimin e fushës së përgjegjësisë nga MAS në MMSR. Megjithatë, AKAFPK ka vijuar punën në zbatim të funksioneve të saj dhe të planit vjetor në përputhje me buxhetin e miratuar nga MAS.

Në kontekstin e reformimit të sistemit, AKAFPK është angazhuar në bashkëhartimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020, në hartimin e plan-veprimit të Strategjisë, posaçërisht në lidhje me prioritetet dhe B dhe D të kësaj Strategjie.

AKAFPK ka mbështetur MMSR-në në konceptimin dhe zbatimin e procesit të reformës, nëpërmjet angazhimit të saj në procesin e hartimit të akteve nënligjore dhe të të gjitha procesve të tjera, pavarësisht se ky institucion ka qenë vetë pjesë e një faze tranzicioni.

Në 25 shkurt 2014, me anë të *Urdhrit nr. 50 të Ministres së Arsimit dhe Sportit* është emëruar drejtori i ri i AKAFPK-së.

Në po të njëjtën periudhë (26.2.2014), AKAFPK është përfshirë në Shërbimin Civil, pasi ka përfunduar me sukses procesi i vlerësimit të procedurave të përcaktuara nga Drejtoria e Administratës Publike me mbështetjen e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në MMSR.

Menjëherë pas emërimit të drejtorit të ri, në institucion janë përcaktuar kriteret e vlerësimit të punonjësve në përputhje me dispozitat e Ligjit të Nëpunësit Civil dhe Kodin e Punës.

Pas përfundimit me sukses së procedurës së vlerësimit fillestar nga Drejtoria e Administratës Publike, të gjithë punonjësit e AKAFPK-së kanë marrë konfirmimin e statusit të nëpunësit civil.

Në periudhën 1 janar-30 prill 2014, AKAFPK nuk ka mundur të operacionalizojë buxhetin për zbatimin e planit vjetor të punës sipas buxhetit vjetor të miratuar nga MAS për vitin 2014, për shkak të mungesës së bazës ligjore, ose më saktë, të kontradiktës që është krijuar ndërmjet dispozitave të Ligjit të Prokurimeve Publike dhe profilit të shërbimeve të institucionit.

Gjatë kësaj periudhe (janar-prill 2014), institucioni ka shlyer *vetëm detyrimet e prapambetura* nga viti 2013, për të cilat është shpenzuar 1/3 e zërit përkatës të buxhetit të miratuar nga MAS për aktivitetet e vitit 2014 (zëri 602).

Pas kërkesave dhe vendosjes së procedurave transparente për aktivizimin e buxhetit (me mbështetjen e Sekretarit të Përgjithshëm të MAS) vetëm në maj 2014 nisi puna për zhvillimin e të gjitha shërbimeve që AKAFPK duhet të realizojë për vitin 2014.



Gjatë periudhës maj-dhjetor 2014, janë angazhuar të gjithë sektorët e institucionit që të përfundojnë në kohë aktivitetet dhe shërbimet për t'u vënë në dispozicion të MMSR-së dhe shkollave profesionale, por edhe përdoruesve të tjerë të shërbimeve të institucionit. Gjatë kësaj periudhe, megjithë ndryshimet (shtesa dhe pakësime) e bëra nga Ministria e varësisë (MAS), ky buxhet ka arritur të mbështesë veprimtaritë e planifikuara të AKAFPK-së në përputhje me planin e këtij viti.

Të gjitha produktet e realizuara nga AKAFPK për t'u vënë në dispozicion të shkollave dhe qendrave të formimit profesional janë përcjellë në rrugë zyrtare dhe në formë elektronike Sekretarit të Përgjithshëm, Drejtorisë së Arsimit dhe Formimit Profesional në MMSR.

Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve në Ligjin Nr. 8872 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë" ndryshuar me Ligjin 63/2014, AKAFPK po përgatit bazën ligjore për funksionimin dhe reformimin e institucionit nën varësinë e MMSR-së.

AKAFPK ka identifikuar funksionet e përcaktuara nga Ligji i AFP-së, Ligji i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020 dhe në bazë të këtyre funksioneve janë identifikuar dhe paraqitur në projekt-buxhet nevojat për burime njerëzore, financiare dhe infrastrukturë, të cilat rezultojnë të domosdoshme.

Është hartuar drafti i plan-biznesit të institucionit, i mbështetur në analizën SWOT, i cili mbetet për t'u plotësuar me planin e veprimit dhe termat financiarë.

### Sfidat

AKAFPK është një institucion, puna dhe suksesi i të cilit lidhet ngushtë me mënyrën e konceptimit të sistemit të arsimit dhe formimit profesional në tërësi. Ndarja e roleve të institucioneve do të krijonte një profil të qartë të AKAFPK-së.

Zhvillimi i organizatës lidhet ngushtë me funksionet e institucionit nën varësinë e MMSR-së dhe vendosja e rrugëve të komunikimit ndërinstitucional. Parakusht për këtë mbetet: miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave për "Organizmin dhe Funksionimin e AKAFPK-së në varësi të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë", miratimi i organikës dhe i statutit e rregullores së brendshme.

Gjithashtu, ristrukturimi dhe funksionimi i AKAFPK-së kërkon mbështetje ligjore për zhvillimin e veprimtarive që kontribuojnë në zbatimin e reformës dhe Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020. Në këto kushte, në muajin dhjetor është propozuar një projekt Vendim i Këshillit të Ministrave për pagesat e bashkëpunorëve që angazhohen në realizimin e veprimtarive zhvillimore në fushën e arsimit dhe formimit profesional, në varësi



tashmë të MMSR-së, duke kërkuar domosdoshmërisht miratimin e zërave për pagesat e veprimtarive, të cilat nuk ekzistojnë në aktet e deritanishme ligjore dhe nënligjore.

Zhvillimi i burimeve njerëzore, përmirësimet në infrastrukturë dhe diversifikimi i burimeve financiare do të rezultojnë në rritje të kapaciteteve njerëzore në numra dhe cilësi

### *Aktivite të tjera të institucionit janar-dhjetor 2014*

Në kuadrin e projektit FRAME të zbatuar nga ETF dhe të projektit EU-ILO-IPA 2010, specialistët e AKAFPK-së janë angazhuar intensivisht në procesin e hartimit të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020, të plan-veprimit dhe të planit të monitorimit të kësaj strategjie.

Specialistë të AKAFPK-së kanë qenë pjesë e grupeve intervistuese gjatë kryerjes së studimit të shkollave dhe qendrave të formimit profesional.

AKAFPK është një institucion i përfshirë në shumë forume, grupe pune të institucioneve të BE-së dhe UNESCO-s:

1. Grupi i punës për Arsimin dhe Formimin Profesional në kuadër të strategjisë ET2020<sup>1</sup>
2. Qendra Kombëtare për koordinimin e dy programeve Euroguidance dhe EPALÉ nën Erasmus<sup>2</sup>
3. Anëtare e rrjetit të agjencive rajonale të arsimit dhe formimit profesional SEEVET Net
4. Pjesëmarrëse (online) në grupin e punës së UNESCO-s për “Rishikimin e Rekomandimeve mbi arsimin dhe formimin profesional” (qershor-korrik 2014)
5. Bashkëpunëtore e Sekretariatit të ERISSEE dhe SEECCEL

Në kuadër të nismës së OECD-së për përfshirjen e vendeve të Ballkanit Perëndimor në studimin PIAAC (Programme for the International Assessment of Adult Competencies), AKAFP ka marrë pjesë në dy trajnime fillestare dhe është konsultuar – me porosi të MMSR-së – me projekte dhe donatorë, të cilët mund të ndihmojnë përfshirjen e Shqipërisë në këtë studim.

AKAFPK në bashkëpunim me ETF-në po realizon studimin e nevojave për kualifikime profesionale bazuar në nevojat kombëtare dhe rajonale të ekonomisë, informacioni vlefshëm për të bërë përditësimin e Draftit të Listës Kombëtare të Kualifikimeve Profesionale e cila është e lidhur me nivelet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

AKAFPK ka intensifikuar bashkëpunimin me partnerët socialë: shoqatat e biznesit dhe sindikatat. Në kuadër të veprimtarive për lidhjen dhe bashkëpunimin me biznesin si dhe për

---

<sup>1</sup> Drejtori i AKAFPK-së është nominuar nga Ministrija e Arsimit dhe Sportit si pikë kombëtare kontakti sipas kërkesës së Komisionit Europian drejtuar përfaqësisë së Republikës së Shqipërisë në Bruksel

<sup>2</sup> Vendosur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit



promovimin e Arsimit Profesional, me nismën e MEGATEK, dhe mbështetjen e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK), e partnerëve të tjerë si GIZ, SWISSCONTACT, VODAFONE, etj., u organizua “**Olimpiada e Aftësive Profesionale**” 2014, aktiviteti vjetor më i madh për Arsimin Profesional në Shqipëri.

Në datën 10 shtator 2014, AKAFPK nënshkroi një Memorandum Bashkëpunimi me BiznesAlbania dhe kompaninë gjermane të trajnimeve DEKRA me synimin për të aplikuar dhe zbatuar projekte të përbashkëta në mbështetje të arsimit profesional.

Gjithashtu, AKAFPK do të bashkëpunojë me BiznesAlbania, AITA, GIZ për të mbështetur qendrën multifunksionale Kamëz në përmirësimin e kurrikulës së drejtimit “Teknologji informacioni dhe komunikimi”

Drejtori dhe punonjësit e AKAFPK-së kanë qenë pjesë e grupeve të ndryshme të punës të ngritur nga MMSR dhe ka koordinuar aktivitetin e saj në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Punësimit dhe Formimit Profesional në MMSR.

Me kërkesën e MAS, AKAFPK është përfshirë në procesin e zhvillimit të Maturës Shtetorëre (në muajt maj-qershor) dhe në procesin e verifikimit të dokumentacionit të studentëve të Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) të mbyllura.

Gjithashtu me kërkesën e MAS, AKAFPK ka bërë vlerësimin e të gjithë teksteve të botuar nga BOTEM në periudhën 2012-2014 sipas informacioneve të ofruara nga ky institucion dhe portali ekzistues i arsimit dhe formimit profesional.

Gjatë 17-18 Nëntor 2014 u zhvillua në Tiranë, takimi i përbashkët i Klasterit të Dijes në AFP (CoK on VET me seli në Rumani) me Rrjetin Rajonal të AFP-së në Europën Juglindore (SEEVET-Net) organizuar nga ERISEE<sup>3</sup> me mbështetjen e AKAFPK. Fokusi i këtij seminari ishte “Të nxënit bazuar në Punë”- si një çështje prioritare në sigurimin e adresimit të nevojave të tregut të punës dhe të ekonomisë nga sistemi i AFP-së

Mbështetur në Ligj nr. 117/2014, datë 11.09.2014 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në PROGRAMIN “ERASMUS +”, Programi i BE-së për Arsimin, Trajnimin, Rininë dhe Sportin, AKAFPK ka aplikuar dhe ka fituar projektin mbi “Skemat e Çirakërisë për Punësimin e të Rinjve në Shqipëri” me nr. 556911-EPP-1-2014-1-AL-EPPKA3-APPREN, dhe edhe në nëntor 2014 është nënshkruar Marrëveshja e Grantit me nr. 2014-3358/001-001 për zbatimin e veprimtarive të projektit të AKAFPK-së.

---

<sup>3</sup> Education Reform Initiative for South Eastern Europe



## *Shërbime të realizuara sipas planit vjetor të punës<sup>4</sup>*

### **Lista e përshkrimeve të profesioneve të përfunduara (30 Përshkrime profesionale) gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2014**

- 216 Arkitektë, projektues, studiues dhe dizenjues
- 2220 Infermierë dhe mami
- 312 Përgjegjës prodhimi (mbikëqyrës)
- 3113 Teknikë të inxhinierisë elektrike
- 3114 Teknikë të inxhinierisë elektronike dhe telekomit
- 3115 Teknikë të inxhinierisë mekanike
- 3121 Përgjegjës në minierë
- 3122 Përgjegjës prodhimi
- 3123 Përgjegjës ndërtimi
- 3152 Teknikë peshkimi
- 3221 Profesioniste infermierë
- 3321 Përfaqësues sigurimesh
- 3333 Kontaktues dhe agjentë punësimi
- 3334 Menaxherë dhe agjentë të pasurive të patundshme
- 5141 Parukiere/berberë
- 6310 Prodhues të produkteve bujqësore për nevoja familjare
- 6320 Prodhues të produkteve blegtorale për nevoja familjare
- 7124 Instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse
- 7125 Punëtorë të pastrimit të konstruksioneve të ndërtesave
- 7129 Punëtorë ndërtimi të tjerë jo të klasifikuar diku tjetër
- 7233 Mekanik, montues, riparues të makinave bujqësore dhe industriale
- 7234 Riparues të biçikletave dhe të tjerë të ngjashëm
- 7536 Lëkurëpunues, regjës të lëkurës, përpunues të gëzofit dhe të ngjashëm
- 7542 Punëtorë të lëndëve plasëse dhe shpërthimeve
- 8111 Minatorë dhe punëtorë të gurores
- 8153 Punëtorë të makinave qepëse

---

<sup>4</sup> AKAFPK është një ofrues shërbimesh publike për Ministrinë përgjegjëse, për institucionet e arsimit dhe të formimit profesional. Gjithashtu, në zbatim të Ligjit për Arsimin dhe Formimin Profesional dhe të Ligjit të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, AKAFPK zhvillon dy instrumente shumë të rëndësishme, të cilat ofrohen për një përdorim shumë më të gjerë, siç janë: Lista Kombëtare e Profesioneve dhe Korniza Shqiptare e Kualifikimeve (në përputhje me Kornizën Europiane të Kualifikimeve).





- 8155 Punëtorë të makinave të përgatitjes së lëkurës dhe gëzofit
- 8156 Punëtorë të makinave të prodhimit të këpucëve dhe galanterisë
- 9311 Punëtorë në miniera e gurorë
- 9313 Punëtorë të ndërtimit të banesave

**Lista e përshkrimeve të kualifikimeve profesionale të përfunduara gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2014:  
(17 përshkrime kualifikimesh profesionale)**

- Reception, niveli II në KKKP (niveli III në KSHK)
- Rrobaqepësi, niveli II në KKKP (niveli III në KSHK)
- Peshkim, niveli I në KKKP (niveli II në KSHK)
- Modelim, niveli II në KKKP (niveli III në KSHK)
- Guidë turistike, niveli II në KKKP (niveli III në KSHK)
- Riparim të pajisjeve elektronike, niveli II në KKKP (niveli III në KSHK)
- Telekomunikacion, niveli II në KKKP (niveli III në KSHK)
- Ferma Bujqësore dhe Blegtorale, niveli II në KKKP (niveli III në KSHK)
- Kopshtari, niveli II në KKKP (niveli III në KSHK)
- Peshkim, niveli II në KKKP (niveli III në KSHK)
- Mbarështim të kafshëve dhe shpendëve, niveli II në KKKP (niveli III në KSHK)
- Teknologji e përpunimit të naftës, niveli II në KKKP (niveli III në KSHK)
- Llogari, niveli III në KKKP (niveli IV në KSHK)
- Frutikulturë, niveli II në KKKP (niveli III në KSHK)

**Në kuadrin e mbështetjes së Projektit EU-ILO-IPA 2010**

- Shërbime Detare në Kuvertë, niveli IV në KKKP (niveli V në KSHK)
- Kontrolli Laboratorik i Ushqimit, niveli IV në KKKP (niveli V në KSHK)
- Dizenjim mode (Fashion designer), niveli IV në KKKP (niveli V në KSHK)

**Standardet e profesioneve dhe analiza e profesionit metodën DACUM të zhvilluara me mbështetjen e Projektit EU-ILO-IPA 2010:**

- I. Në kuadrin e pilotimit të mekanizmit të NJNM në fushën e tekstil-konfeksioneve dhe galanterisë, u hartuan me pjesëmarrjen e ekspertëve nga bizneset fasone:
  - Standardi i profesionit “Teknik Prodhimi”
  - Standardi i Profesionit “Kontrollor Cilësie”



II. Me pjesëmarrjen ekskluzive të përfaqësuesve të ekspertëve të detarisë, si dhe të stilistëve të modës në vend, u hartuan:

- *Karta DACUM për "Shërbime Detare në Kuvertë";*
- *Karta DACUM për "Dizenjues mode" (Fashion Designer).*

**Lista e skeletkurrikulave të reja për arsimin profesional (8 skeletkurrikula) të përfunduara gjatë periudhës janar- dhjetor 2014:**

1. Profili "Agrobiznes" Niveli III".
2. Profili "Shërbime karrocierie", Niveli II
3. Profili "Elektromekanikë" Niveli II
4. Profili "Teknologjia e prodhimit të verës" Niveli II.

U hartuan edhe katër skeletkurrikula për kualifikimet profesionale pas të mesmes (në bashkëpunim me Programin EU-ILO-IPA 2010).

5. Profili "Shërbime detare në kuvertë", niveli IV
6. Profili "Instruktur i AFP", niveli IV.
7. Profili "Laborator i kontrollit ushqimor", niveli IV.
8. Profili "Dizenjim mode", Niveli IV

**Lista e programeve të kurseve të shkurtra profesionale (2 programe) të përfunduara gjatë periudhës janar- dhjetor 2014:**

1. Profili "Minator dhe Armator" (300 orë).
2. Profili "Zjarrmëtar" (210 orë).

**Lista e materialeve mësimore mbështetëse për lëndët e arsimit profesional (20 materiale mësimore) të përfunduara gjatë periudhës janar- dhjetor 2014:**

1. Për lëndën "Elektroteknikë dhe matje elektrike" kl.10, drejtimi "Elektroteknik"
2. Për lëndën "Histori e kostumeve dhe e modës", kl.13, drejtimi "Tekstil - Konfeksione".
3. Për lëndën "Sistemet moderne në mjetet e transportit", kl.13 të drejtimit "Shërbime mjetesh transporti".
4. Për lëndën "Kontabilitet", kl.13 të drejtimit "Hoteleri turizëm".
5. Për lëndën "Veglat dhe makinat e përpunimit të drurit", kl. 10-11 të drejtimit "Përpunim druri".



6. Për lëndën “Përmirësimi ujqor dhe sistemimi i tokave”, kl.13 të drejtimit “Bujqësi”.
7. Për lëndën “Rrjete kompjuterike”, kl.11 të drejtimit “TIK”.
8. Për lëndën “Ushqim”, kl. 12, të profileve “Bar restorant” dhe “Kuzhinë pastičeri”.
9. Për lëndën “Makinat elektrike”, kl. 11 (temat 1-5), të drejtimit “Elektroteknik”.
10. Për lëndën “Makinat elektrike”, kl. 11 (temat 6-10), drejtimi “Elektroteknik”.
11. Për lëndën “Ekonomi ferme”, kl. 11, (temat 1-5) të drejtimit “Ekonomi bujqësore”.
12. Për lëndën “Ekonomi ferme”, kl. 11, (temat 6-10) të drejtimit “Ekonomi bujqësore”.
13. Për lëndën profesionale “Teknologji ushqimore dhe ftohje”, kl.11, të drejtimit “Teknologji ushqimore”.
14. Për lëndën profesionale “Elektroteknikë dhe matje”, kl.11, të drejtimit “Elektroteknikë”.
15. Për lëndën “Bazat e kompjuterit”, kl. 10, të drejtimit “Teknologji informimi dhe komunikimi”.
16. Për lëndën “Njohuri për mjetet e transportit”, kl. 10, (temat 1-9), të drejtimit “Shërbime mjetesh transporti”.
17. Për lëndën “Njohuri për mjetet e transportit”, kl. 10, (temat 10-16), të drejtimit “Shërbime mjetesh transporti”.
18. Për lëndën “Organizimi dhe ligjshmëria në shërbime mjetesh transporti,” kl.13, (temat 3-11, të drejtimit “Shërbime mjetesh transporti”.
19. Për lëndën “Gjeologji e përgjithshme”, kl.10, të drejtimit “Gjeologji miniera”.
20. Për lëndën “Art minerar”, kl.10, të drejtimit “Gjeologji miniera”.

**Lista e programeve orientuese dhe instrumenteve të vlerësimit për provimet e niveleve në arsimin profesional dhe udhëzimet përkatëse**

1. 3 programe orientuese për dy drejtime mësimore (të dërguara në MAS)
  - a) “Ekonomi bujqësore” (niveli I)
  - b) “Teknologji agroushqimore” (niveli I)
  - c) “Prodhim bimor” (niveli II)
2. Vlerësim i zbatimit të programeve orientuese dhe zhvillimit të provimeve në të tri nivelet e arsimit të mesëm profesional (raport i dërguar në MMSR)
3. Udhëzues për grupet e punës për hartimin e bankave të testeve;
4. Gjashtë banka, **me nga 200 njësi testi secila**, për drejtimet:
  - a) “Shërbim Mjetesh Transporti”
  - b) “TIK”
  - c) “Ndërtim”
  - d) “Hoteleri-Turizëm”



- e) "Elektroteknikë"
- f) "Mekanikë"
- 5. "Udhëzues metodik për hartimin e njësive të testit me zgjedhje të shumëfishtë" (website-i i Agjencisë);
- 6. Vlerësim i gjëndjes së vlerësimit të kursantëve në qendrat publike të formimit profesional (raport i dërgar MMSR);
- 7. Hartimi i Udhëzimit për përdorimin e bankës së testeve nga ana e shkollave/qendrave;
- 8. Propozim për një model të ri të akreditimit të ofruesve të AFP-së.

**Përmirësimi i infrastrukturës dhe i mënyrës së ofrimit të shërbimeve të AKAFPK-së**

- 1. Krijimi i një faqeje të re interneti me adresë [www.akafp-al.org/al](http://www.akafp-al.org/al) dhe rifreskim i saj
- 2. Rregullore e brendshme mbi rekrutimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm, miratuar nga sekretari i përgjithshëm, MAS.
- 3. Manual mbi mirëmbajtjen dhe rifreskimin e Faqes së re të AKAFPK-së.
- 4. Plotësimi me informacione dhe me dokumenta (produkte) i faqes së re
- 5. Përgatitja e dokumentacionit për DAP për statusin e Nëpunësit Civil
- 6. Shlyerja e detyrimeve financiare të prapambetura të vitit 2013, lidhur me aktivitetet e AKAFPK-së, për zërin "Honorare" në shumën 3365047 lekë.
- 7. Realizimi i pagesave të aktiviteteve të periudhës janar- dhjetor 2014, në përputhje me planifikimet vjetore.
- 8. Projekt buxheti i 2015, 2016, 2017, dërguar në MAS dhe MMSR.
- 9. Në zbatim të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil" dhe Vendimit nr. 109, datë 26/02/2014, të Këshillit të Ministrave, "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil", u realizua faza e vlerësimit vjetor të stafit të AKAFPK-së.

## ANEKS

### Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale. Raport, Janar - Dhjetor 2014

Objektivat sipas planit vjetor të sektorit Strategjisë bashkëpunimeve me projekte	Arritjet gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2014 për arritjen e objektivit vjetor/rezultatet	Problematika/Shënime	Afati i realizimit
<b>1. Zbatimi i Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP)</b>	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Bashkëpunim më Zyrën e Punës Tiranë për përdorimin e LKP.</li><li>2. Koordinimi i punës me dhomën e fasonëve për të grumbulluar informacion lidhur me rishikimin e LKP, si dhe këshillim përfaqësuesve të kompanive të fasonëve në përdorimin e LKP në sektorin e tekstil-konfeksioneve</li><li>3. Këshillim përfaqësuesve të industrisë së minierave në përdorimin e LKP.</li><li>4. Në kuadrin e këshillimit të përdoruesve të Listës Kombëtare të Profesioneve, lidhur me mënyrën e përdorimit të saj dhe përshkrimet përkatëse të profesioneve, takim me përfaqësues të kompanisë së prodhimit të këpucëve MITO, Berat. Në kuadrin e rishikimit të Listës Kombëtare të profesioneve:</li><li>5. Takime në Drejtorinë Rajonale të Punësimit</li></ol>	Zhvillimi i intervistave të strukturuar me përfaqësues të kompanive të ndryshme dhe zyrave të punësimit për të grumbulluar informacion lidhur me profesione/pozicione të munguara në tregun e punës.	Janar-Prill Prill-Maj Maj Korrik-Gusht Gusht-Dhjetor



	<p>Durrës, në kompaninë Albartin Shipping Co në fushën e detarisë, dhe Kantinën e Durrësit të prodhimit të verës, për të grumbulluar informacionin për zhvillimin e profesioneve në këtë rajon.</p> <p>6. Vizitë në Kombinatin e Përpunimit të Thellë të Naftës (KPTHN), në TEC, në Qendrën e Prodhimit të Naftës Ballsh – Amonicë, si dhe takim me përfaqësues të Zyrës së Punësimit, në Ballsh, për të grumbulluar informacionin për zhvillimin e profesioneve në këtë zonë.</p> <p>7. Vizitë në Kompanitë Birra Korça (prodhimi i birrës) dhe Tona Co shpk (përpunimi i mishit), si dhe në Drejtorinë Rajonale të Punësimit, në Korçë për të grumbulluar informacionin për zhvillimin e profesioneve në këtë rajon.</p> <p>8. Takime në Drejtorinë Rajonale të Punësimit Vlorë dhe biznese për të grumbulluar informacionin për zhvillimin e profesioneve në këtë rajon, ne kuadrin e rishikimit të Listës Kombëtare të Profesioneve.</p> <p>9. Takime në zyrën e punësimit Berat, si dhe në subjekte të ndryshme private në fushën e agropërpunimit, konfeksioneve, galanterisë dhe prodhimit të materialeve të</p>		
--	---	--	--

RAPORT I AKTIVITETIT VJETOR



	<p>ndërtimit, për të grumbulluar informacionin për zhvillimin e profesioneve në këtë rajon.</p> <p>10. Përkthime në website-in e ILO të elementeve të ISCO-2008, në kuadrin e rishikimit të Listës Kombëtare të Profesioneve.</p>		
<p><b>2. Hartimi i përshkrimeve të profesioneve për nivele të ndryshme të kompetencës (sipas LKP)</b></p>	<p>1. Grumbullim informacioni (në internet dhe burime të tjera të dhënash), përkthime dhe përpunim i informacionit për hartimin e përshkrimit të <b>30 profesioneve</b> në Listën Kombëtare të Profesioneve (përkatësisht me kode 216, 2220, 312, 3121, 3113, 3114, 3115, 3122, 3123, 3152, 3221, 3321, 3333, 3334, 5141, 6310, 6320, 7124, 7125, 7129, 7233, 7234, 7536, 7542, 8111, 8153, 8155, 8156, 9311, 9313).</p> <p>2. Ndjekja e procedurave për rekrutimin dhe seleksionimin e grupeve të punës për hartimin e përshkrimit të 30 profesioneve.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përpilimi i njoftimit për pjesëmarrje në grupet e punës</li> <li>• Përgatitja e një formulari tip për aplikim.</li> <li>• Seleksionimi i kandidatëve dhe përgatitja e kontratave</li> </ul> <p>3. Në bashkëpunim me përfaqësues të minierës së Bulqizës, u modeluan takimet për hartimin e 4 përshkrimeve të profesioneve të</p>	<p>Janë hartuar 30 përshkrime profesionesh nga 25 të planifikuara për t'u hartuar. Ndër to, 4 janë hartuar në bashkëpunim me specialistët e kompanisë "Albchrome" dhe të QFP të Lëvizëshme.</p> <p>Procedura të ngurta administrative dhe financiare vështirësojnë rekrutimin e ekspertëve të profesionit.</p>	<p>Janar-Dhjetor</p> <p>Maj</p>

RAPORT I AKTIVITETIT VJETOR



	<p>industrisë minerare, me kode 3121, 7542, 8111 dhe 9311.</p> <p>4. Moderimi i takimeve me ekspertë nga biznesi dhe formatimi i informacionit për përshkrimin e 30 profesioneve në Listën Kombëtare të Profesioneve.</p>		Janar-Dhjetor
<p><b>3. Rishikimi i draftit të Listës Kombëtare të Kualifikimeve Profesionale</b></p>	<p>1. Me mbështetjen e ETF, u zhvilluan takimet konsultative në rajonet e Korçës, Gjirokastrës, Vlorës, Fierit, Shkodrës, Lezhës dhe Durrësit, me përfaqësues të organizatave të biznesit, sindikatave, anëtarë të bordeve të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional, zyra të punës, pushtetit vendor dhe përfaqësues të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional publik dhe privat, universitetit, etj., duke synuar identifikimin e nevojave për kualifikime në këtë rajon, në përputhje me prioritet rajonale të zhvillimit ekonomik dhe tendencat në punësim.</p> <p>2. Me mbështetjen e ETF-GIZ, u zhvillua takim konsultativ në Kamëz me përfaqësues të partnerëve socialë dhe aktorëve të tjerë për të evidentuar sektorët dhe profilet në nevojë për t'u adresuar nga oferta e AFP-së.</p>		Shtator-Dhjetor
<p><b>4. Hartimi i përshkrimeve të kualifikimeve</b></p>	<p>1. Grumbullim informacioni (në internet dhe burime të tjera të dhënash), përkthime dhe</p>	Janë hartuar 17 përshkrime	Janar-Dhjetor





	<p>përpunim i informacionit për hartimin e përshkrimit të 14 kualifikimeve profesionale.</p> <p>2. Takime në shkollën “Hoteleri-Turizëm”, “Karl Gega”, “Gjergji Canco”, Shkollën Teknike Ekonomike në Tiranë, si dhe me përfaqësues të biznesit për të koordinuar veprimtarinë për hartimin e përshkrimeve të kualifikimeve profesionale në fushat e tekstilit, hotelerisë dhe turizmit, ekonomi-financës, elektronikës, etj.</p> <p>3. Ndjekja e procedurave për rekrutimin dhe seleksionimin e grupit të punës për hartimin e përshkrimit të <b>14 kualifikimeve profesionale</b>.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përpilimi i njoftimit për pjesëmarrje në grupet e punës</li> <li>• Përgatitja e një formulari tip për aplikim.</li> <li>• Seleksionimi i kandidatëve dhe përgatitja e kontratave</li> </ul> <p>4. Moderimi i takimeve me grupet e punës për hartimin e 14 përshkrimeve të kualifikimeve profesionale.</p> <p>5. Formatimi i informacionit për hartimin e përshkrimit të 14 kualifikimeve profesionale në nivelet 2 - 4 të KSHK.</p>	<p>kualifikimesh profesionale nga 10 të planifikuara për t’u hartuar gjatë vitit.</p> <p>Nga këto, 3 përshkrime kualifikimesh profesionale pas të mesme janë hartuar me mbështetjen e EU-ILO-IPA 2010</p>	
<p><b>5. Veprimtari të tjera në kuadrin e bashkëpunimit me</b></p>	<p><b>Nw kuadrin e projektit EU-ILO-IPA 2010:</b></p> <p>1. Kontribut në hartimin e metodologjisë për zhvillimin e standardeve të profesioneve,</p>		<p>Maj-Nëntor</p>



<p><b>projektet (EU-ILO-IPA 2010, DEKRA, ETF, etj.)</b></p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>2. Kontribut në procesin e hartimit të 2 standardeve të profesioneve, në kuadrin e prezantimit të mekanizmit të Njohjes së të Nxënit të Mëparshëm”, Projekti EU-ILO-IPA 2010.</li> <li>3. Takime me përfaqësues së universitetit, shkollës profesionale “Karl Gega”, dhomave të fasonëve dhe sindikatave, për hartimin e standardeve të profesioneve.</li> <li>4. Pjesëmarrje në procesin e hartimit të dy standardeve të profesionit, në kuadrin e prezantimit të mekanizmit të Njohjes së të Nxënit të Mëparshëm”, Projekti EU-ILO-IPA 2010.</li> <li>5. Takime me përfaqësues të projektit IPA për hartimin e skeletkurrikulave për 4 profile në nivelin pas të mesëm në fushat e tekstil-konfeksioneve, detarisë, teknologjisë ushqimore dhe ne specialitetin e instruktorëve të AFP-së.</li> <li>6. Zhvillimi i konsultës me ekspertë nga fusha e detarisë për të artikuluar nevojat për kualifikime në këtë fushë.</li> <li>7. Organizimi dhe moderimi i një workshopi 2-ditor me ekspertë të detarisë për të zhvilluar analizën e fushës profesionale “Shërbime detare në kuvertë” me metodën DACUM.</li> <li>8. Koordinimi i veprimtarive për seleksionimin</li> </ol>		
---	---	--	--



	<p>e grupit të punës, moderimi i takimeve dhe formatimi i informacionit për hartimin e përshkrimit të kualifikimit profesional “Shërbime detare në kuvertë” (niveli i pestë në KSHK).</p> <p>9. Koordinimi i veprimtarive për seleksionimin e grupit të punës, moderimi i takimeve për hartimin e përshkrimit të kualifikimit profesional “Kontroll Laboratorik i Ushqimit” (niveli i pestë në KSHK).</p> <p>10. Koordinimi i veprimtarive dhe moderimi i takimeve të grupit të punës për hartimin e përshkrimit të kualifikimit dhe formatimi i informacionit për kualifikimin profesional “Kontroll laboratorik ushqimor” (niveli i pestë në KSHK).</p> <p>11. Koordinimi i veprimtarive dhe zhvillimi i ëorkshopit 2-ditor DACUM për profesionin “Dizenjues mode” në fushën e konfeksioneve.</p> <p>12. Koordinimi i veprimtarive për hartimin e përshkrimit të kualifikimit profesional “Dizenjim Mode”, Niveli i pestë në KSHK.</p> <p>13. Koordinimi i veprimtarive, dhe modelimi i takimeve për hartimin e përshkrimit të kualifikimit profesional “Dizenjim Mode”, Niveli i pestë në KSHK.</p> <p>14. Formatimi i informacionit për hartimin e</p>		
--	--	--	--



	<p>përshkrimit të kualifikimit “Dizenjim mode” (niveli i pestë në KSHK).</p> <p>15. Takim me ekspertin e projektit EU-ILO-IPA 2010, në kuadrin e misionit të tij për mbështetjen e AKAFP.</p> <p>16.</p> <p><b>Ne kuadrin e ETF:</b></p> <p>17. Me mbështetjen e ETF, pjesëmarrje në EUROSILLS 2014, Lille, France, për të parë mundësinë e një anëtarësimi të mundshëm të Shqipërisë në këtë event ndërkombëtar.</p> <p>18. Pjesëmarrje në “FRAME Foresight Peer Learning Activity” në Maltë e Torino, organizuar nga ETF.</p> <p>19. Në kuadrin e studimit të gjendjes së shkollave/qendrave të organizuar nga GIZ dhe ETF, vizitë në 15 shkolla dhe qendra të formimit profesional, për të intervistuar drejtuesit dhe vëzhguar mjediset.</p> <p>20. Në kuadrin e studimit të gjendjes së shkollave/qendrave të organizuar nga GIZ dhe ETF, takim i grupit të punës për të bërë vlerësimin final të ofruesve të AFP-se sipas kritereve të eficiencës së brendshme dhe efektivitetit të jashtëm.</p> <p>21. Takim me përfaqësues të ETF për të pasqyruar situatën e deritanishme në zhvillimin e KKKP si nënsektor i KSHK, si</p>		
--	---	--	--



	<p>dhe për të artikuluar nevojat e SPKP në këtë drejtim.</p> <p>22. Pjesëmarrje në Konferencën “Making Better Qualifications” në Bruksel, organizuar nga ETF.</p> <p>23. Pjesëmarrje në Konferencën “Skills and Qualifications” në Bruksel, organizuar nga KE.</p> <p><b>Në kuadrin e SECEEL:</b></p> <p>24. Kontribut në grupin e punës për hartimin e rezultateve të të Nxënit për Sipërmarrjen, në nivelin ISCED 3, organizuar nga SECEEL.</p> <p><b>DEKRA:</b></p> <p>25. Pjesëmarrje në ceremoninë për nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet AKAFPK, DEKRA Academy dhe Biznes Albania, si dhe ndjekja e dy takimeve konsultative për bashkëpunimin potencial.</p> <p><b>Cultural Heritage Without Borders</b></p> <p>26. Takim me përfaqësues të “Cultural Heritage Without Borders” për zhvillimin e kualifikimeve në fushën e restaurimit, në Gjirokastrë.</p>		
<p><b>6. Veprimtari të tjera në kuadrin e bashkëpunimit me</b></p>	<p>1. Kontribut në grupin e punës për hartimin e strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim 2014-2020.</p>		<p>Janar-Dhjetor</p>



<p><b>MMSR, MAS dhe institucione të tjera</b></p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>2. Pjesëmarrje në vizitën studimore në Vienë, për të grumbulluar informacion lidhur me zhvillimin e skemës së çirakërisë në AFP.</li> <li>3. Pjesëmarrje në vizitën studimore në Hamburg, për të grumbulluar informacion lidhur me qasjen e administrimit të ofruesve të AFP në këtë vend.</li> <li>4. Pjesëmarrje në Olimpiadën e Aftësive, organizuar nga MEGATEK.</li> <li>5. Asistencë MAS, për verifikimin e dosjeve të studentëve të Universiteteteve të mbyllura</li> <li>6. Vizitë në shkollën profesionale “Çarls Telford Erikson” Golem për të analizuar gjendjen e saj, si dhe për të studiuar mundësitë për mbështetje.</li> <li>7. Pjesëmarrje në analizën 3-mujore të veprimtarisë së DRFP, në Shkodër.</li> <li>8. Pjesëmarrje në takimin “Mundësitë për përmirësimin e procedurave të licencimit të subjekteve private që ofrojnë formim profesional”, organizuar nga MMSR.</li> <li>9. Pjesëmarrje në procesin e monitorimit të maturës shtetërore.</li> <li>10. Kontribut në trajnimin për integrimin gjinor në zhvillimin e kualifikimeve dhe në tregun e punës.</li> <li>11. Përgatitja e komenteve dhe sugjerimeve për draftet e akteve ligjore dhe nënligjore që</li> </ol>		
---	--	--	--

RAPORT I AKTIVITETIT VJETOR



	<p>lidhen me ligjin e rishikuar të AFP, të hartuara nga një grup pune në MMSR.</p> <p>12. Takim me përfaqësues të MMSR për qasjen e zhvillimit të kurseve të formimit profesional.</p> <p>13. Pjesëmarrje dhe prezantim në konferencën “Të nxënit në punë”, e organizuar nga ERISSEE në Tiranë.</p> <p>14. Pjesëmarrje dhe prezantim në konferencën e parë vjetore “Aftësi më të larta dhe punë më të mirë për të gjithë”, organizuar nga ILO-IPA 2012.</p> <p>15. Pjesëmarrje në takimin konsultativ për kuadrin ligjor në AFP, organizuar nga ETF.</p> <p>16. Prezantime të ndryshme në konferenca, simpoziume, media, etj. për çështje të AFP-së në vend.</p>		
<p><b>7. Veprimtari të tjera në mbështetje të AKAFPK</b></p>	<p>1. Zhvillimi i metodologjisë për të përgatitur analizën SWOT të Sektorit, dhe grumbullim i strukturuar i informacionit nga secili punonjës i sektorit, në kuadrin e hartimit të nje plani zhvillimit të AKAFPK.</p> <p>2. Përpilimi i objektivave individuale të secilit punonjës në sektor, sipas formatit të DAP, për qëllim të vlerësimit të performancës së stafit dhe ndjekja e procedurës për vlerësimin e stafit.</p> <p>3. Plotësimi i formularëve për shërbimet publike</p>		<p>Janar-Dhjetor</p>

## RAPORT I AKTIVITETIT VJETOR



	<p>që ofrohen nga SPKP, në kuadër të veprimtarisë së AKAFPK-së.</p> <ol style="list-style-type: none"><li>4. Kontribut në kuadrin e komisionit të prokurimeve me vlera të vogla.</li><li>5. Përpilimi i projekt-buxhetit për sektorin e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale.</li><li>6. Përgatitja e draft-propozimit për zërat financiare në mbështetje të veprimtarisë së sektorit në të ardhmen.</li><li>7. Përpilimi i një programi pune për mentorimin e praktikantit të përcaktuar për të bërë praktiken ne Sektor, mentorimi i përditshëm në përputhje me programin dhe nevojat e Sektorit dhe vlerësimi përfundimtar i praktikantit.</li><li>8. Përpilimi i planeve dhe raporteve periodike për ecurinë e veprimtarisë së sektorit.</li><li>9. Mbështetje për plotësimin e faqes së internetit të AKAFPK.</li></ol>		
--	---	--	--





Sektori i Sekeltkurrikulave dhe Standardeve të Trajnimit të Mësuesve. Raport, Janar - Dhjetor 2014

Objektivat sipas planit vjetor të sektorit Strategjisë bashkëpunimeve me projekte	Arritjet gjatë periudhës Janar - Dhjetor për arritjen e objektivit vjetor/rezultatet	Problematika/Shënime	Afati i realizimit
I. HARTIMI I DOKUMENTACIONIT KURRIKULAR.			Mars –Dhjetor 2014
1. Hartimi i 7 Skeletkurrikulave të kualifikimeve profesionale të AP.	<p>- U krye analiza e nevojave për skeletkurrikula të reja.</p> <p>- U hartuan kriteret, u bënë njoftimet, u përzgjedhën antarët e grupeve dhe vijoi puna për hartimin e 4 Skeletkurrikulave të reja për vitin shkollor 2014-2015:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Profili “Agrobiznes” Niveli III”.</li> <li>2. Profili “Shërbime karrocerie”, Niveli II</li> <li>3. Profili “Elektromekanikë” Niveli II</li> <li>4. Profili “Teknologjia e prodhimit të verës” Niveli II.</li> </ol> <p>- U hartuan edhe 4 skeletkurrikula për kualifikime profesionale pas të mesmes (në</p>	<p>Megjithëse njoftimet ishin bërë për hartimin e 7 Skeletkurrikulave të reja, për 3 prej tyre Komisioni nuk përzgjedhi antarë grupesh sepse:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për Skeletkurrikulin e Profilit “Mbrojtje e mjedisit pyjor”, Niveli III, nuk u paraqit asnjë kandidaturë.</li> <li>- Për Skeletkurrikulin e Profilit “Marketing bujqësor”, Niveli III, u gjykua që ky profil mbulohet nga Profili “Agrobiznes”, niv. III.</li> <li>- Për Skeletkurrikulin e Profilit “Teknologjia e prodhimit të verës”,</li> </ul>	Mars –Dhjetor 2014



	<p>bashkëpunim me Programin EU-ILO-IPA 2010)</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Profili “Shërbime detare në kuvertë”, niveli IV</li> <li>2. Profili “Instruktor i AFP”, niveli IV.</li> <li>3. Profili “Laborator i kontrollit ushqimor”, niveli IV.</li> <li>4. Profili “Dizenjim mode”, Niveli IV</li> </ol> <p>- Janë marrë informacione nga shkollat profesionale në 8 qytetet kryesore, në lidhje me zbatimin e skeletkurrikulave të AP dhe është përgatitur Raporti përkatës.</p>	<p>Niveli II, u gjykua që ky profil mbulohet nga Profili “Teknologji e prodhimit të pijeve”, niv. II.</p>	
<p><b>2. Përgatitja e 7 paketave mësimore mbështetëse për zbatimin e lëndëve dhe moduleve profesionale të AP</b></p>	<p>- Fillimisht u hartuan 2 Paketa mësimore dhe më pas u analizuan nevojat, si dhe u përcaktua lista e 18 Paketave mësimore mbështetëse të tjera për tu hartuar.</p> <p>- U përcaktuan kriteret për autorët, u shpallën njoftimet, u përcaktuan dhe u kontraktuan autorët për hartimin 18 Paketave mësimore.</p> <p>- Në total, u hartuan 20 Paketa mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Për lëndën “Elektroteknikë dhe matje elektrike” kl.10, drejtimi “Elektroteknik”</li> <li>2. Për lëndën “Histori e kostumeve dhe e modës”, kl.13, drejtimi “Tekstil - Konfeksione”.</li> <li>3. Për lëndën “Sistemet moderne në mjetet e transportit”, kl.13 të drejtimit “Shërbime</li> </ol>	<p>- Fillimisht u planifikuan 7 Paketa mësimore për tu hartuar, më pas u shtuan edhe 13 paketa të tjera për tu hartuar me fondet që u bënë disponibël nga pakësimi i numrit të skeletkurrikulave të planifikuara për tu hartuar.</p>	<p>Mars –Dhjetor 2014</p>



	<p>mjetesh transporti”.</p> <p>4. Për lëndën “Kontabilitet”, kl.13 të drejtimit “Hoteleri turizëm”.</p> <p>5. Për lëndën “Veglat dhe makinat e përpunimit të drurit”, kl. 10-11 të drejtimit “Përpunim druri”.</p> <p>6. Për lëndën “Përmirësimi uJOR dhe sistemimi i tokave”, kl.13 të drejtimit “Bujqësi”.</p> <p>7. Për lëndën “Rrjete kompjuterike”, kl.11 të drejtimit “TIK”.</p> <p>8. Për lëndën “Ushqim”, kl. 12, të profileve “Bar restorant” dhe “Kuzhinë pastičeri”.</p> <p>9. Për lëndën “Makinat elektrike”, kl. 11 (temat 1-5), të drejtimit “Elektroteknik”.</p> <p>10. Për lëndën “Makinat elektrike”, kl. 11 (temat 6-10), drejtimi “Elektroteknik”.</p> <p>11. Për lëndën “Ekonomi ferme”, kl. 11, (temat 1-5) të drejtimit “Ekonomi bujqësore”.</p> <p>12. Për lëndën “Ekonomi ferme”, kl. 11, (temat 6-10) të drejtimit “Ekonomi bujqësore”.</p> <p>13. Për lëndën profesionale “Teknologji ushqimore dhe ftohje”, kl.11, të drejtimit “Teknologji ushqimore”.</p> <p>14. Për lëndën profesionale “Elektroteknikë dhe matje”, kl.11, të drejtimit “Elektroteknikë”.</p> <p>15. Për lëndën “Bazat e kompjuterit”, kl. 10, të drejtimit “Teknologji informimi dhe komunikimi”.</p>		
--	--	--	--

## RAPORT I AKTIVITETIT VJETOR



